



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.06.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.06.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik "N.T.P."GRESA - COMMERCE", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet", Nr. i prokurimit- 632-24-1656-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-017-121, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " N.T.P."GRESA - COMMERCE", e dt.05.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pelet", Nr. i prokurimit- 632-24-1656-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-017-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 31.05.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **31.05.2024**;

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " N.T.P."GRESA - COMMERCE " me dt.05.06.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet", Nr. i prokurimit- 632-24-1656-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-017-121.



Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.06.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues është dashur të ju kërkoj sqarime në bazë të nenit 72 të LPP-së, nuk qëndron, sepse ju nuk keni prezentuar kontratat e punëtorëve, të cilat janë dokument të cilat mund të prodhohen dhe vërtetësia e tyre nuk mund të vërtetohet në mënyrë objektive, prandaj nuk ju janë kërkuar sqarime në bazë të nenit 72 të LPP-së as për pikat tjera.

Në bazë të nenit 72 të LPP-së, mund të kërkojen vetëm dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar:

Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.


Pretendimi juaj se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk plotëson Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezentuar dy kontrata për furnizim me pelet me operator privat të cilat mbulojnë kërkesat në FDT-së, dhe për të cilat Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime – fatura dhe transaksione bankare në bazë të nenit 72 të LPP-së, të cilat ky operator i ka prezentuar duke plotësuar kështu kërkesën e Autoritetit kontraktues në FDT-ë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
